



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 06.07.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 2 dhe 6 korrik 2018, shqyrtoi nën për nën dhe në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, i cili është paraqitur nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81, 82 të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

Paketa e re fiskale që na paraqitet tregon angazhimin e qeverisë shqiptare për të siguruar mbështetjen e vazhdueshme për sipërmarrjen dhe garantimin e rritjes së qëndrueshme të tyre që në fund, prodhon punësim.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar parashikon ndryshimin e 5 neneve ekzistuese të ligjit. Këto ndryshime janë konsultuar në shkallë të gjerë edhe me grupet e interesit dhe shoqatat e bizneseve në vend. Ato propozojnë lehtësira fiskale të qenësishme për zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë shqiptare siç janë bujqësia dhe turizmi, të cilat në vizionin e qeverisë, shihen si sektorë që do të garantojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim, nxitje të ndërmarrjeve të vogla e të mëdha, më shumë të ardhura e më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë.

Ndryshimet e propozuara janë në vëjimësi të reformave të nisura nga Qeveria si programi i “Rilindjes Urbane dhe Rurale”, për të cilin deri në vitin 2017 janë rikonstruktuar rreth 300 mijë metër rrugë, rreth 20 mijë metra bulevarde dhe shëtitore, rreth 200 mijë m² sheshe dhe qendra urbane si dhe qendra historike, rreth 150 mijë m² parqe dhe nga kanë përfituar mbi 1.8 milionë shqiptarë si dhe rreth 3 mijë biznese të cilat ushtrojnë aktivitetin në zonat e transformuara prej tyre. Apo programi i 100 fshatrave

dhe krijimi i rrjetit të agroturizmit shqiptar që synon të krijojë për herë të parë modelin e suksesit në zhvillimin e integruar rural të vendit, sipas standardeve më të mira evropiane.

Në mënyrë të detajuar disa nga masat konkrete të propozuara në secilin nga nenet e projektligjit konsistojnë në:

- Rishikimin e fjalisë së parë të pikës 1, të nenit 11 “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, duke bërë harmonizimin e terminologjisë për pasurinë e paluajtshme sipas ndryshimeve të fundit të bëra në ligjin për taksat vendore, të cilat u propozuan nga përfaqësuesit e dhomave të tregtisë dhe industrisë.
- Rishikimin e fjalisë së dytë të pikës 1, të nenit 11 dhe shfuqizimin e pikave 3 dhe 4 të nenit 20 “Shpenzimet e njohura”, sipas të cilave tanimë shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi në bazë të një kontratë shkëmbimi nuk do të përbëjë më moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital. Këto ndryshime kërkojnë rregullimin e skemës së taksimit për investitorët dhe pronarët e truallit në ndërtim dhe si rrjedhojë investitorit nuk do ti llogaritet më si e ardhur e tatueshme pjesa që i korrespondon sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit dhe as si shpenzim i zbritshëm vlera e truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës. Propozimet e mësipërme kanë reflektuar shqetësimet e paraqitura nga Shoqata e Ndërtuesve për ngarkimin me një barrë tatimi jo të drejtë të tyre që prej vitit 2006.
- Rishikimin e përcaktimeve të nenit 28 “Shkalla tatimore” duke propozuar aplikimin e dy shkallëve tatimore 5% dhe 15 % për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin. Kështu është propozuar që tatimpaguesit me qarkullim nga 8 milionë deri në 14 milion lekë ti nënshtrohen një tatimi tre herë më të ulët prej 5 % nga 15% përqind që është aktualisht sot. E thënë ndryshe nga ky ndryshim do të përfitojnë 10,850 biznese, ose gjysma e bizneseve që paguajnë tatim fitimin.
- Uljen e tatim fitimit nga 15% në 5% për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor të cilat operojnë sipas ligjit nr.38/2012. Ky ndryshim vjen në vazhdimësi të ndryshimeve të tjera që kanë përfituar gjatë këtij viti këto shoqëri siç është dhe rimbursimi i TVSH-së në masën 20 %, apo subvencionimi, investimi në kullim dhe ujitje dhe asistencë financiare e BE-së e dhënë nëpërmjet IPARD.
- Zhvillimin e sektorëve të veçantë të turizmit, siç është dhe agroturizmi për të cilën është propozuar aplikimi i një norme të reduktuar të tatim fitimit në masën 5 %, për një periudhë 10 vjeçare. Ndryshimin e sipërpërmendur do e përfitojnë të gjithë ato struktura akomoduese të cilat do të përfitojnë statusin “subjekt i çertifikuar agroturizmi” nga 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2021.
- Rishikimin e përcaktimeve të nenit 33/1 “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit” me qëllim harmonizimin e nenit më përcaktimet e bëra në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pra duke hequr detyrimin për depozitimin e vendimit për miratimin e rezultatit vjetor e destinimin e fitimit për personin fizik si dhe vendosjen e gjobës për çdo rast të mosdepozitimit të vendimit të asamblesë së oratakëve dhe jo për çdo muaj vonesë.
- Riformulimin e paragrafit të dytë të nenit 38 “Dispozita kalimtare” me qëllim saktësimin e përkufizimit të të ardhurave bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojrave të fatit si dhe unifikimin e këtij paragrafi me përcaktimet e tjera të bëra në ligjet e fushës.

Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e ndryshimeve që përmban ky projektligj do rregullohen edhe nëpërmjet akteve nënligjore siç është përshembull edhe rishikimi i udhëzimit për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme i cili nuk ka ndryshuar që nga vitit 2008.

Masat e propozuara do të shoqërohen me efekte fiskale të cilat do të reflektohen në buxhetin e vitit të ardhshëm duke qenë se ndryshimet e propozuara në nenin 28, do të hyjnë në fuqi në 1 janar të 2019.

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni e miratoi projektligjin nën për nen dhe në terësi me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me ndryshimet e mëposhtme:

- Para nenit 1, futet një nen i ri me këtë përmbajtje:

“Në nenin 8/1 “Të ardhurat e përjashtuara”, pika 11, paragrafi i parë zëvendësohet me fjalitë e mëposhtme:

“Të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër, apo një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor. Përjashtohen gjithashtu rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe /ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr 7501 date 19.07.1991 “Për tokën”.

- Në pikën 2, të nenit 3, të projektligjit pika 4 e shtuar riformulohet, me këtë përmbajtje:

“4. Subjektet, të cilët zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5%. Kjo shkallë, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi” deri në 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfitimit të statusit “subjekt i certifikuar agroturizmi”.

RELATOR

Blerina GJYLAMETI

KRYETARI

Erion BRAÇE

Tiranë, më 06.07.2018